

Polica konfiskoi armë zjarri e thikë gjatë arrestimit të Arbër Havollit



24/10/2025 08:53

f

🐦

🔗

Policia e Kosovës të enjten ka arrestuar Arbër Havollin, i dyshuari për vrasjen e 44-vjeçarit, Bashkim Spahiu, që ndodhi në Llapashticë të Epërme të Podujevës më 6 shtator të këtij viti.

Havoli ishte në kërkim prej shumë kohësh dhe i njëjti u arrestua në Podujevë.

Policia ka njoftuar se tek i njëjti gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar një armë zjarri dhe një thikë.

“Njësitet policore kanë ndërmarrë një operacion në Prishtinë, i cili ka rezultuar me arrestimin e personit të dyshuar: A.H, mashkull, 31 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili ishte i shpallur në kërkim nën dyshimin e bazuar për përfshirje në veprën në fjalë. Veprimet e mëtejme lidhur me personin e dyshuar do të merren në koordinim me Prokurorin e Shtetit”, thuhet në njoftimin e policisë.

Me vendim të prokurorit, i njëjti pas intervistimit dërgohet në mbajtje./Lajmi.net/

LAJME TË FUNDIT

Gjashtë të vrarë pasi SHBA-ja sulmon një anije në Karaibe

Osmani: Kam lexuar raporte që sivjet Serbia ka...

Limaj: Dyshoj se Kuvendi është i konstituuar, vijnë...

Gjini për Kurtin: I pandershëm, jo fisnik e as burrështetas

Artikuj të ngjashëm



October 24, 2025
Gjashtë të vrarë pasi SHBA-ja sulmon një anije në Karaibe



October 24, 2025
Osmani: Kam lexuar raporte që sivjet Serbia ka tentuar të na...



October 24, 2025
Limaj: Dyshoj se Kuvendi është i konstituuar, vijnë në një situatë...



October 24, 2025
Gjini për Kurtin: I pandershëm, jo fisnik e as burrështetas



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B/r. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information